



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

**“ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË APELIT
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR
VITIN 2023”**

I. HYRJE

Në këtë raport vjetor përshkruhet veprimtaria e plotë dhe organizimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si gjykata e vetme e apelit të juridiksionit të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, e cila filloi funksionimin në datën 01.02.2023, sipas Vendimin nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Raporti vjetor përmban një përshkrim të përgjithshëm të gjykatës, procesin e punës në gjykatë, menaxhimin e seancave gjyqësore, aktorët e sistemit të drejtësisë, të dhëna për çështjet e mbartura, administrimin e gjykatës, veprimtarinë e gjykatës, afatet kohore procedurale, duke paraqitur një vlerësim analitik të punës së të gjithë strukturave të saj, me synim evidentimin e rezultateve të arritura. Dokumenti “Analiza Vjetore e Gjykatës” përfaqëson në mënyrë të përmbledhur analizën e punës së kryer dhe performancën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm gjatë vitit kalendarik 2023, si dhe parashtron problematikat e konstatuara, gjatë këtij viti, përse i përket funksionimit të institucionit në tërësi dhe sfidat për vitin 2024 e në vijim. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2023 është përpjekur që nëpërmjet vendimeve të realizoj misionin bazë të saj, që është ai i dhënies së drejtësisë, si dhe të garantojë zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor.

Në brendësi të analizës paraqiten gjithashtu edhe të dhëna në formë grafike dhe tabelare mbi çështjet e paraqitura në gjykatë, kohëzgjatjen, çështjet për të cilat ka përfunduar gjykimi, statistika mbi rekursët, cilësinë në gjykim.

Vlen të përmendet se është përballuar një volum shumë i madh pune me një numër të reduktuar gjyqtarësh. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në datën 1 Shkurt 2023 e kanë ushtruar detyrën efektivisht 25 gjyqtarë, të cilët kanë kompetencën për shqyrtimin e çështjeve që gjykohen nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm me shtrirje të veprimtarisë në gjithë territorin e Republikën e Shqipërisë.

Me vendimin nr.1, datë 02.02.2023 të Këshillit të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm *“Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve të çështjeve penale me të mitur në konflikt ne ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale”*, janë krijuar seksioni penal dhe seksioni civil. Seksioni penal është përbërë nga 13 gjyqtarë dhe seksioni civil nga 12 gjyqtar, pra nëntë trupa gjykues: pesë në seksionin penal dhe katër në seksionin civil. Për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale janë caktuar gjithsej 4 gjyqtar.

Me shkarkimin e një gjyqtari, në datën 23 Shkurt 2023, nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka ngelur me 24 gjyqtarë. Me vendimin nr.3, datë 24.02.2023 të Këshillit të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm *“Për disa ndryshime ne vendimin nr.1, date 02.02.2023, te Keshillit te Gjykates te Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem, “Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve e çështjeve penale me të mitur në konflikt ne ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale”*, janë krijuar seksioni penal dhe seksioni civil. Seksioni penal është përbërë nga 12 gjyqtar dhe seksioni civil nga 12 gjyqtar, pra tetë trupa gjykues: katër në seksionin penal dhe katër në seksionin civil. Për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale janë caktuar gjithsej 4 gjyqtarë.

Gjatë vitit 2023, gjyqtare Vojsava Osmanaj me dekretin nr.185, datë 03.08.2023 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë. Me vendimin nr.13, datë 29.09.2023 të Këshillit të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm “ *Për disa ndryshime ne vendimin nr.1, date 02.02.2023, te Keshillit te Gjykates te Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem, “Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve e çështjeve penale me të mitur në konflikt ne ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale”*”, janë krijuar seksioni penal dhe seksioni civil. Seksioni penal është përbërë nga 10 gjyqtarë dhe seksioni civil nga 12 gjyqtar dhe për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale janë caktuar gjithsej 4 gjyqtar.

Gjyqtar Valbon Çekrezi me dekretin nr.250, datë 27.09.2023 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Me vendimin nr.17, datë 31.10.2023 të Këshillit të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm “ *Për disa ndryshime ne vendimin nr.1, date 02.02.2023, te Keshillit te Gjykates te Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem, “Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve e çështjeve penale me të mitur në konflikt ne ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale”*”, janë krijuar seksioni penal dhe seksioni civil. Seksioni penal është përbërë nga 13 gjyqtarë dhe seksioni civil nga 12 gjyqtar: pesë trupa gjykues në seksionin penal dhe katër në seksionin civil. Për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale janë caktuar gjithsej 4 gjyqtar.

Gjyqtare Emona Muçi është zgjedhur anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe e ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, deri në datën 12.12.2023.

Gjyqtar të ngritur në detyrë pranë Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për vitin 2023, janë:

- Qemal Zaimi Vendimi nr.585 datë 18.10.2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Marsela Pepi Vendimi nr. 583 datë 18.10.2023i Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Alma Kolgjoka Vendimi nr. 634 datë 19.10.2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Brikena Ukperaj Vendimi nr. 736 datë 12.12.2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, e rikthyer në pozicionin e gjyqtares pasi përfundoi mandatin e anëtares së Këshillit të Lartë gjyqësor.

Me vendimin nr.36, datë 13.12.2023 të Këshillit të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm “ *Për disa ndryshime ne vendimin nr.1, date 02.02.2023, te Keshillit te Gjykates te Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem, “Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve e çështjeve penale me të mitur në konflikt ne ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale”*”, janë krijuar seksioni penal dhe seksioni civil. Seksioni penal është përbërë nga 13 gjyqtarë dhe seksioni civil nga 12 gjyqtar: pesë trupa gjykues në seksionin penal dhe katër në seksionin civil. Për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale janë caktuar gjithsej 4 gjyqtar.

Gjyqtar të shkarkuar me vendim të formës së prerë, nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për vitin 2023, janë gjithsej 11 gjyqtarë.

DHOMA CIVILE DHE PENALE	
ORGANIKA	78 gjyqtarë
GJYQTARË QË USHTROJNË DETYRËN DERI NË 31.12.2023	23 gjyqtarë mesatarisht
GJYQTARË TË SHKARKUAR NGA KPA, GJATË VITIT 2023	11 gjyqtarë

Pamvarësisht prurjeve të reja me tre gjyqtarë që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor, përsëri ky numër ka mbetur i njëjtë gjatë vitit 2023, dhe është larg plotësisht të strukturës aktuale prej 78 gjyqtarë, që do të mundësonte një frymëmarrje normale kësaj gjykate, gjykimit të çështjeve në një afat të arsyeshëm dhe sa më të shpejt kohor.

Përveç ngarkesës së çështjeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjyqtarët e kësaj gjykate kanë përballuar edhe çështjet të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shkak të komandimeve pranë kësaj gjykate.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vazhdon ta ushtroj aktivitetin në të njëjtën godinë që ka patur Gjykata e Apelit Tiranë, në godinën 3 katëshe, në të cilin janë të akomoduar gjyqtarët dhe stafi administrativ. Gjyqtarët që ushtrojnë funksionin janë të akomoduar në zyra më vete, dhe stafi administrativ në paradhomë.

Për vitin 2023 kanë qenë në funksion shtatë salla gjykimi (njëra nga të cilat është për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale). Të gjitha sallat janë me sistem audio, dhe një sallë është edhe me sistem video.

Këtu dua të theksojë se me fondin e alokuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në vitin 2022, është kryer brenda një afati të shpejt kohor (2muaj e gjysëm) rikonstruksioni i bodrumit dhe në to janë magazinuar dosjet gjyqësore që presin radhën për gjykim, si dhe një sallë gjyqi, për zhvillimin e çështjeve penale, masa sigurimi apo penale me të arrestuar, duke patur akses të drejtëpërdrejtë të pandehurit dhe toga e shoqërimit nga ambienti i izolimit.

Sqarojmë këtu se godina nuk plotëson kushtet e një gjykate me standartet e nevojshme, por jemi përpjekur të krijojmë kushtet dhe të marrim të gjitha masat për të mundësuar zhvillimin normal të proceseve dhe krijimin e një ambienti të sigurt, si për gjyqtarët ashtu edhe për stafin administrativ, apo për palët dhe përfaqësuesit e tyre.

Janë marr masa nga ana e gjykatës që ambienti në pjesën hyrëse, i cili ka qenë me kontratë qiradhënie nr.186 prot, datë 01.10.2018, "Bar Kafe", duke u bazuar në rekomandimin e auditit ambienti është përshtatur në zyrë, për administratën e gjykatës. Aktualisht në këtë ambient janë sistemuar punonjës pjesë e administratës.

Këshillin i Lartë Gjyqësor ka luajtur një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm dhe ndihmës efektive në zgjidhjen e problematikave të ndryshme të hasura gjatë këtij viti sfidues, në trajnimin e stafit të gjykatës me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre në fusha respektive, si dhe në gatishmërinë për të mbajtur një frymë komunikimi dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm. Por, çmujmë se në kushtet aktuale në të cilat gjendet gjykata, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është bërë sa duhet duke mos marrë masa për mbarëvajtjen e punës në këtë institucion, me qëllim që të rritej efica dhe efikasiteti në gjykimin e çështjeve, duke u përkthyer në një shërbim më të mirë dhe më të shpejtë ndaj publikut, pra duhet të

ishte krijuar mundësia që gjykata të ushtronte veprimtarinë gjyqësore në një ambient me standarte e parametra të përshtatshëm dhe njëkohësisht të ishte shtuar numri i gjyqtarëve të gjykatës. Problematika dhe situata në të cilën po ushtron veprimtarinë gjykata është e njohur për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Kështu, me shkresën nr.2749, datë 27.03.2023 dhe më shkresën 14060 prot, datë 12.10.2023, i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesë për shtimin e numrit të gjyqtarëve, pasi për vitin 2023, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka funksionuar me një numër gjyqtarësh, në masën 28 % si dhe po me shkresë kemi kërkuar sigurimin e ambienteve shtesë, pasi godina aktuale ku ushtrohet veprimtaria gjyqësore nuk ka kapacitete të mjaftueshme.

Përsa më lartë, nuk kemi asnjë përgjigje lidhur me godinën e gjykatës dhe vazhdojmë ta ushtrojmë aktivitetin në të njëjtën godinë, edhe pse në këtë godinë de facto e ushtrojnë veprimatrinë gjashtë gjykata apeli.

Këshilli i Gjykatës së Apelit Tiranë me vendimin nr. 1 datë 04.01.2023 bazuar në vendimin nr.556, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor vendosi “Miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” si dhe rregullat standart, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në ish Gjykatat e Apeleve vazhdojnë të ushtrojnë funksionin zyrat e shërbimeve.

Zyrat e shërbimeve janë ngritur dhe funksionojnë në Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër si pjesë e strukturës së gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm në përputhje me parashikimet e këtij vendimi ku parashikohet dhe veprimtaria e Zyrate të Shërbimit në periudhë kalimtare ku punonjësit e Zyrate të Shërbimit kryejnë të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor si dhe veprimet që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 31 janar 2023. Zyrat përbëhen nga tre nëpunës civil gjyqësor, dhe përveç shërbimit ndaj publikut këto zyra vazhdojnë të evadojnë edhe dosjet gjyqësore, kryerjen e veprime lidhur me komunikimin e vendimeve/rekurseve. Me zyrat e shërbimit kemi komunikim të përditshëm, të menjëhershëm.

II. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

1. NGARKESA DHE LLOJI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Në bazë të Vendimit nr. 505, datë 21.11.2022 “PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS SË APELIT TË JURIDISKIONIT TË PËRGJITHSHËM”, nenit 6, titulluar “Transferimi i çështjeve gjyqësore” janë transferuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër, Gjirokastrë dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit në ato gjykata. Në total janë transferuar **33731** çështje gjyqësore. Transferimi në sistemin ICMIS është realizuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në databazën e gjykatës si dhe të kompanisë të kontraktuar nga ana e tyre. Në datën 03.02.2023, nën monitorimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor u hodhën në short elektronik çështjet e paplanifikuara për gjykim të gjykatave të Apelit Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë dhe Shkodër. Për shkak të çështjeve mediatike, ndër to, shorti është kryer në prezencë të medias dhe çështjet u shpërndanë pothuajse në mënyrë të barabartë mes gjyqtarëve. Ndërkohë janë shortuar/plotësuar të gjitha çështjet e planifikuara për gjykim, duke mos shkaktuar vonesa nga ana e stafit administrativ lidhur me kalimin e praktikës gjyqtarëve relatorë.

Këshilli i Gjykatës, pas mendimit të dhënë nga mbledhja e gjyqtarëve, ka miratuar aktet përkatëse për ndarjen e gjyqtarëve në seksione, duke krijuar trupa gjyqësore brënda dhomave, duke marrë për bazë edhe fushën ku është emëruar gjyqtari sipas KLGJ-së. Në përbërje të seksionit civil janë 12 “dymbëdhjetë” gjyqtar të cilët janë ndarë në 4 (katër) trupa gjykues të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë. Në përbërje të seksionit penal janë 12 “dymbëdhjetë” gjyqtarë të cilët janë ndarë në 4 (katër) trupa gjykues të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë. Për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale janë caktuar gjithsej 4 gjyqtar.

Aktet e miratimit të ndarjes së gjyqtarëve në trupa gjykues janë publikuar menjëherë në faqen zyrtare të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për njohje nga publiku dhe mbi bazën e kësaj ndarje është zhvilluar dhe shorti.

Në datën 01.02.2023, numri total i çështjeve gjyqësore është **33.731**, nga të cilat të **9.845** të natyrës penale dhe **23.886** të natyrës civile. Çështje të regjistruara të reja nga data 01 Shkurt 2023 - 31 Dhjetor 2023 janë **12.146 çështje**. Numri i çështjeve të shqyrtuara në total për vitin 2023 (nga data 1 shkurt) është **8.215** çështje gjyqësore.

2. LIKUJDIMI/PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE

VOLUMI I ÇËSHTJEVE 1 SHKURT-31 DHEJTOR 2023	
Çështje të mbartura deri ne 31.01.2023	33.731
Çështje të regjistruara të reja	12.146
Çështje të gjykuara	8.215

Volumi i çështjeve (periudha 01 Shkurt -31 Dhjetor 2023)			
Totali	Të mbartura deri ne 31.01.2023	Të regjistruara të reja	Të gjykuara
45.877	33.731	12.146	8.215

Tabela 1 volumi i çështjeve




Figura 1-paraqitja grafike e volumit të çështjeve

Totali (mbartur +regjistruar)	Të gjykuara
33.731	8.215



Figura 2- Paraqitja grafike e çështjeve %

Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se:

1. Në lëndën penale janë gjykuar në total 4.817 çështje. Në këtë numër përfshihen çështje penale themeli, penale të posaçme, kërkesa penale-administrative, kërkesa penale gjatë hetimeve paraprake, kërkesa penale në fazën e ekzekutimit të dënimit.
2. Në lëndën civile janë gjykuar 3.398 çështje. Në këtë numër përfshihen çështje civile themeli, kërkesa civile.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, rezulton se ngarkesa me çështje gjyqësore e gjykatës është shumë e lartë, pasi për pjesën më të madhe të vitit 2023, gjykata ka patur mesatarisht 23 gjyqtar. Për shkak të volumit të lartë të çështjeve për gjyqtar, janë trajtuar me prioritet çështjet penale që janë të karakterit urgjent.

Tabela me të dhënat e çështjeve për 01 Shkurt-31.12.2023

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 shkurt)	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. çështjeve në shqyrtim
1.	Valdete Hoxha	525	262	224	763
2.	Edlira Petri	1000	497	315	1282
3.	Arta Duka	1845	540	290	2095
4	Genti Shala	972	509	295	1300
5	Astrit Kalaja	1800	615	275	2140
6	Elona Toro	1851	578	535	1894
7	Fatri Islamaj	978	484	343	1229
8	Alma Ahmeti	1807	572	385	1994
9	Marsela Dervishi	1866	545	455	1956
10	Ornela Naqellari	1813	563	396	1980
11	Irida Kacerja	1836	535	354	2017
12	Elona Mihali	1835	526	374	1987
13	Emona Muci	986	483	309	0
14	Lutfije Celami	1035	508	382	1291
15	Dritan Hasani	993	519	407	1251
16	Fuat Vjerdha	944	484	313	1215
17	Genti Dokollari	1067	473	412	1228
18	Iliba Bezati	1877	576	473	1980
19	Irena Brahim	1021	483	241	1263
20	Miranda Andoni	1915	522	282	679
21	Sokol Pina	1954	556	416	2094
22	Valbon Çekrezi	1078	292	168	0
23	Valbona Vata	1780	531	355	1956

24	Vojsava Osmanaj	953	264	139	0
25	Alma Kolgjoka	0	82	26	2211
26	Qemal Zaimi	0	62	30	633
27	Marsela Pepi	0	56	16	620
28	Brikena Ukperaj	0	29	5	604
TOTALI		33731	12146	8215	37662




Figura 3- Ngarkesa e gjyqtarëve të seksionit Penal




Figura 4- Ngarkesa e gjyqtarëve të seksionit Civil

Norma e zgjidhjes/likuidimit të çështjeve “Clearance rate”, (që është raporti i thjeshtë i dalë nga pjestimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, i shprehur në përqindje), në vitin 2023 është 67.635 %. Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon nëse gjykata ka qenë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim në vitin 2023 dhe për rrjedhim nëse edhe një pjesë e çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm janë zgjidhur. Norma e likuidimit jo e afërt me 100% është tregues jo i kënaqshëm për likuidimin e çështjeve.

- Për të gjitha çështjet e shqyrtuara në gjykatë në vitin 2023, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “Clearance rate” është 67.635%

$$\text{Clearance rate} = \frac{8.215 \text{ [numri i çështjeve te gjykuara]}}{12.146 \text{ [numri i çështjeve te reja per 2023]}} \times 100 = 67.635 \%$$

- Për çështjet e natyrës penale, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “Clearance rate” është 72.39 %

$$\text{Clearance rate} = \frac{4.817 \text{ [numri i çështjeve te gjykuara]}}{6.654 \text{ [numri i çështjeve te reja per 2023]}} \times 100 = 72.39 \%$$

- Për çështjet e natyrës civile, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “Clearance rate” është 61.87%

$$\text{Clearance rate} = \frac{3.398 \text{ [numri i çështjeve te gjykuara]}}{5.492 \text{ [numri i çështjeve te reja per 2023]}} \times 100 = 61.87\%$$

Më poshtë do të shihni tabelën lidhur me statistikën e çështjeve penale dhe civile, treguesit e efikasitetit në të cilën rezulton se norma e likuidimit të çështjeve është 68 %, për periudhën 11 mujore, numri total i dosjeve gjyqësore që presin radhën për shqyrtim në fund të vitit 2023, është 23.030, ose 61 % e stokut të çështjeve. Në total janë zhvilluar 11.451 seanca gjyqësore në audio.

	ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE					TREGUESIT E EFICENCËS				SEANCAT GJYQËSORE	
	Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Të gjykuara	Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	Të regjistruara gjithsej	Norma e likuidimit të çështjeve (%)	Koha deri në zgjidhjen e një çështjeje (ditë)	Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund periudhës	% e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet	Numri i seanceve gjyqësore	Numri i seanceve gjyqësore për çështje
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Çështje civile	23886	5492	3398	25980	29378	62	2791	17280	67	3914	1
Çështje penale	9845	6654	4817	11682	16499	72	885	5750	49	7537	2
GJITHSEJ (A+B)	33731	12146	8215	37662	45877	68 (mes)	1838 (mes)	23030	61 (mes)	11451	1

Tabela 1




Figura 5




Figura 6




Figura 7

STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE				
Numri i gjyqtarëve në gjykatë	Totali i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar	Totali i çështjeve të gjykuara për gjyqtar	Totali i çështjeve për gjyqtar	Totali i çështjeve të mbartura për gjyqtar
23	528	357	1995	1637

a. Çështje penale

Gjate vitit 2023, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë gjykuar 4.817 çështje penale, nga të cilat: 2.545 kërkesa penale të cilat janë gjykuara brënda afatit 10 ditor, të parashikuar në ligj nga gjyqtarët e gatshëm. Për shkak të numrit të lartë të kërkesave penale, është marr vendimi “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente”, sipas listës së gadishmërisë, sipas rendit alfabetik me bazë shkronjën e parë të mbiemrit. Çdo javë janë 3 (tre) gjyqtarë të gatshëm, dhe kërkesat penale (masat e sigurimit, shuarje mase) urgjente pasi regjistrohen hidhen në short elektronik midis gjyqtarëve të gatshëm. Shorti mundësohet nëpërmjet sistemit ICMIS. Shorti elektronik i masave të sigurimit është aplikuar për herë të parë në vitin 2023, për shkak se në listë gadishmërie ka më shumë se një gjyqtar të gatshëm. Nëpërmjet shortit elektronik realizohet shpërndarja e rastësishme dhe sa më e drejtë të çështjeve të regjistruara.

a/1. Dhuna në familje

TE DHËNAT STATISTIKORE PËR DHUNËN NË FAMILJE PER VITIN 2023

• **Vendbanimet**

Vendbanimi	Sasia
Qytet	98
Periferi	60
Fshat	35




Figura 1-Grafiku vendbanimit

• **Mosha**

Moshat	Nr
0-15	1
16-18	1
19-25	8
26-35	36
36-45	62
46-55	38
>55	47




Figura 2-Mosha

• Gjinia

Gjinia	Sasi
Femer	130
Mashkull	63




Figura 3-Gjinia

• Statusi Civil

Statusi Civil	Nr
Beqar/e	13
Martuar	91
Divorcuar	52
Bashkëjetesë	24
i/e ve	13




Figura 4-Statusi Civil

• Numri i Fëmijëve

Numri i Fëmijëve	Nr
Asnjë	23
1 fëmijë	54
2 fëmijë	53
3 fëmijë	46
+4 fëmijë	17




Figura 5-Numri i Fëmijëve

• Niveli i Arsimit

Numri i Fëmijëve	Nr
Asnjë	23
1 fëmijë	54
2 fëmijë	53
3 fëmijë	46
+4 fëmijë	17




Figura 6-Niveli i Arsimit

• Statusi i Punesimit

Statusi i Punesimit	Nr
I papunë	48
I punësuar në sektorin publik	51
I punësuar në sektorin privat	52
I vetëpunësuar	11
Studente	5
Nxënëse	1
Pensionist	25






Figura 7-Statusi i Punesimit

Rritja e rasteve të veprës penale “Dhunës në familje”, lidhet me vazhdueshmërinë e problematikës dhe fenomenit të dhunës në familje. Viktimat e dhunës në familje kërkojnë urdhër mbrojtje dhe ndjekje penale. Në tabelat janë të pasqyruara të dhënat në mënyrë analitike për këtë vepër penale.

Lubi / Čehljepis		STATISTIKAPRI ČEHJEPANALIZI IZ OBLASTI ČEHJEPIS										TRJEŠTE I ČEHJEPIS			SPOVAČIČEHJEPIS					
		ADMINISTRATIVI ČEHJEPIS				KOVIČEVA I ČEHJEPIS IČEHJEPIS						TRJEŠTE I ČEHJEPIS			SPOVAČIČEHJEPIS					
		1	2	3	4	5	Čehljepis <6maja		6-12maja		1-2vjet		>2vje	Kontingencija mesare (dne)	Norma i kaudimite čehljepis (%)	Kada i ne zgljehne čehljepis (dne)	Čehljepis prijete i gijmit nje iud penudis mese	% čehljepis prijete i gijmit nje iud penudis mese	Munni i zanzave djeimare pri čehljepis	Munni i zanzave djeimare pri čehljepis
							M.	%	M.	%	M.	%								
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	
6882	330	2146	8127	10772	12	12	20	11	994	46	791	37	133000	61	1383	346	46	660	2	
40	26	31	37	68	4	15	18	56	9	28	0	0	940	119	488	5	44	46	1	
34	28	40	28	62	9	25	29	72	2	5	0	0	780	146	201	3	44	50	1	
505	219	268	516	784	85	36	124	68	9	3	0	0	14300	122	703	0	0	318	1	
5	4	6	3	9	2	25	3	56	1	0	0	0	1000	150	103	0	0	8	1	
901	61	25	1003	1042	0	0	5	12	12	4	12	41	16140	46	2750	405	40	48	2	
			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2102	301	2693	254	513	257	97	16	1	48	2	5	0	25218	8	351	183	74	203	1	
	246	246	0	246	246	100	0	0	0	0	0	0	1200	100	0	0	0	200	1	
25	22	16	24	46	2	44	2	13	2	13	5	31	8844	72	662	6	44	29	2	
5	18	19	4	23	16	88	1	5	1	5	1	5	3018	100	77	0	0	121	6	
			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9042	6654	4817	11682	16668	2703	59	263	5	1044	20	818	17		72	883	579	48	757	2	

STATISTIKAT PËR ÇËSHTIET PENALE NGA GJYKATA E SHKALLËS SË PARË														
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Në pritje të gjykmimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara						Çështje të gjykuara				Në pritje të gjykmimit në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej
			Çështje të gjykuara		Lënie në fuqi		Dërguar për rigjykim		Te ndryshuara		Tjetër			
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	
1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	3163	3770	2161	790	37	15	1	195	9	1161	54	4772	6933	
2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbini	433	42	165	89	54	4	2	7	4	65	39	310	475	
3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë	504	94	193	85	44	0	0	15	8	93	48	405	598	
4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	233	69	164	91	55	0	0	9	5	64	39	138	302	
5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Diber	429	73	151	118	78	1	1	10	7	22	15	351	502	
6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	888	414	226	142	63	0	0	27	12	57	25	1076	1302	
7 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	251	282	169	121	72	0	0	11	7	37	22	364	533	
8 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë	137	85	133	113	85	0	0	3	2	17	13	89	222	
9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	918	387	285	220	77	4	1	23	8	38	13	1020	1305	
10 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	861	340	198	135	68	0	0	17	9	46	23	1003	1201	
11 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë	240	44	127	108	85	0	0	3	2	16	13	157	284	
12 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	254	136	150	109	73	0	0	13	9	28	19	240	390	
13 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	92	109	138	107	78	1	1	9	7	21	15	63	201	
14 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	94	63	120	101	84	0	0	4	3	15	13	37	157	
15 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Permet	13	12	15	10	67	0	0	1	7	4	27	10	25	
16 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	272	159	190	129	68	2	1	16	8	43	23	241	431	
17 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	111	39	61	42	69	1	2	9	15	9	15	89	150	
18 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder	518	253	77	20	26	4	5	14	18	39	51	694	771	
19 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	135	170	51	6	12	1	2	13	25	31	61	254	305	
20 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë	67	12	7	4	57	0	0	3	45	0	0	72	79	
21 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	162	87	29	11	38	1	3	2	7	15	52	220	249	
22 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë	70	14	7	6	86	0	0	1	14	0	0	77	84	
TOTALI I ÇËSHITJEVE PENALE	9845	6654	4817	2557	53	34	1	405	8	1821	38	11682	16499	



Nisur nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se kriminaliteti është i lartë dhe veprat penale më të përhapura janë: Vrasje me dashje, veprat penale “Dhuna në familje”, “Vjedhje”, “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe veprat penale të lidhura me lëndët narkotike dhe “Armëmbajtje pa leje”. Brënda afatit të parashikuar në ligj janë gjykuar edhe kërkesat penale lidhur me ekstradimet/njohjet e vendimeve penale të huaja.

b. ÇËSHTJET CIVILE

Gjatë vitit 2023, janë gjykuar 3.398 çështje civile, nga të cilat 2.470 çështje civile me palë kundërshtarë. Prioritet i është dhënë gjyqimit të çështjeve familjare (232 çështje janë gjykuar), çështjeve me objekt zgjidhje martesë (219 çështje janë gjykuar), çështjet me objekt dëmshpërblim page, (mardhënie pune 185 çështje janë gjykuar) si dhe kërkesa civile. Brënda afatit ligjor janë gjykuar kërkesat civile, me objekt Urdhër Mbrojtje.

b.1 Kërkesa për Urdhër Mbrojtje

Kërkesa për Urdhër Mbrojtje	Nr
Pranuar	23
Hedhur poshtë	54
Pushuar	53




Figura 8-Kerkese per Urdher Mbrojtje

• Lidhja Familjare me Dhunuesin

Lidhja Familjare me Dhunuesin	Nr
Bashkëshorti/ja	84
Motra	32
Vëllai	24
Fëmija	32
Prindi	7
Të tjerë	14




Figura 9-Lidhja Familjare me Dhunuesin


	Urdhra mbrojtje	Urdhra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithsej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Vendime sipas Nenit 10	57	136	193	164	4	25	0
Subjekte sipas Nenit 13	57	136	193	164	4	25	0

Ligji 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithsej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Neni 10 Pika 1	57	136	193	164	4	25	0
Pika 1.a)	34	130	164	164	0	0	0
Pika 1.b)	34	130	164	164	0	0	0
Pika 1.c)	21	121	142	142	0	0	0
Pika 1.ç)	25	133	158	158	0	0	0
Pika 1.d)	8	118	126	126	0	0	0
Pika 1.ll)	4	18	22	22			
Pika 1.m)							
Pika 1.m/1)							
Neni 13	57	136	193	164	4	25	0
Pika 1.a)	44	0	44	0	0	0	0
Pika 1.b)	13	0	13	0	0	0	0
Pika 3.a)	0	82	82	0	0	0	0
Pika 3.b)	0	54	54	0	0	0	0



Statistikat për çështjet civile sipas llojit të çështjeve

Lloji i çështjes	SHTATIMAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIKAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE																			
	ADMINISTRIM I ÇËSHTJEVE				KOMUNIKIMIN E PËRITURIT TË ÇËSHTJEVE								FREQUENCI E BREVIZAS		SHTATIMAT VËNTORË					
	Me përputhje të plotë me rregullat e procedurës së gjyqësorë	Çështjet e rregulluara sipas rregullat të procedurës së gjyqësorë	Çështjet e rregulluara sipas rregullat të procedurës së gjyqësorë	Me përputhje të plotë me rregullat e procedurës së gjyqësorë	< 4 muaj		6 - 20 muaj		3 - 7 vjet		> 3 vite		Kohëzgjatja mesatare (ditë)	Morrën vendime të gjyqësorë (%)	Kohëzgjatja mesatare e gjyqësorë (ditë)	Kohëzgjatja mesatare e gjyqësorë (ditë)	Kohëzgjatja mesatare e gjyqësorë (ditë)	Çështjet me përputhje të plotë me rregullat e procedurës së gjyqësorë	Çështjet me përputhje të plotë me rregullat e procedurës së gjyqësorë	
					Mir.	%	Mir.	%	Mir.	%	Mir.	%								
A. Çështje civile me palë huadomtare (A.1, A.2, A.3) veçanësisht ato që lidhen me: (A.1.1) (A.2.1) (A.3.1)	21124	4920	2444	23250	36246	0	2082	38	2458	53	296	33	53	2352	35333	66	2395	3	3	
A.1. Veprimtaria civile me palë huadomtare	38233	4800	2400	35840	22203	0	2082	45	2163	55	300	4	63	3456435	63	2323	32448	3000	3	
A.2. Familjar me palë huadomtare	542	200	220	320	320	0	0	314	45	45	300	52	290035	46	3540	882	300	3	3	
A.2.1. Qëllimje Nënose	518	198	220	296	300	0	0	302	46	46	300	54	280000	113	3400	222	198	3	3	
A.3. Tregtare me palë huadomtare	18	4	2	20	22	0	0	0	0	0	2	100	2020	50	3550	33	6	2	3	
A.4. Nënshkrimi pastr	2033	620	380	2500	2000	0	0	50	23	23	320	32	240035	29	4560	3034	0	300	3	
B. Çështje civile me palë huadomtare (B.1, B.2, B.3) veçanësisht ato që lidhen me: (B.1.1) (B.2.1) (B.3.1)	2512	530	500	2420	3220	0	39	42	42	3	420	82	0	0	3000	3000	30	520	3	3
B.1. Veprimtaria civile me palë huadomtare	2512	550	500	2560	3060	0	39	42	42	3	420	84	0	0	3000	3000	30	520	3	3
B.2. Familjar me palë huadomtare	25	34	0	26	42	0	0	2	25	6	6	35	32000	57	3550	25	0	0	3	3
B.3. Tregtare me palë huadomtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
B.3.1. faliment	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C. ÇËSHTJETE CIVILE TË JETË	23000	5420	3330	25500	39070	0	2043	34	2492	58	300	22	63	3456435	33333	67	2394	3	3	

STATISTIKAT PËR ÇËSHTIET CIVILE NGA GJYKATA E SHKALLËS SË PARË													
Gjykatat e Rrethit Gjyqësor	Në pritje të gjyqimit në fillim të periudhës së referuarë	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara						Në pritje të gjyqimit në fund të periudhës së referuarë				
			Çështje të gjykuara		Lënie në fuqi		Dërguar për rregullim		E ndryshuara		Tjetër		Çështje të regjistruara (gjtshë)
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	
1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	13960	3204	1509	1029	68	32	2	97	6	351	23	15655	17164
2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbini	499	35	145	117	81	2	1	6	4	20	14	389	534
3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krutje	436	21	147	117	80	1	1	5	3	24	16	310	457
4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	617	67	120	69	58	1	1	13	11	37	31	564	684
5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Diber	687	71	192	122	64	4	2	17	9	49	26	566	758
6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres	721	246	158	118	75	3	2	11	7	26	16	809	967
7 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	627	75	230	214	93	0	0	5	2	11	5	932	702
8 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavaje	371	64	22	13	59	0	0	3	14	6	27	413	435
9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	2253	589	276	256	93	6	2	5	2	9	3	2526	2802
10 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	684	372	88	69	78	3	3	5	6	11	13	968	1066
11 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje	386	84	74	65	88	1	1	1	1	7	9	396	470
12 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	372	101	64	63	98	0	0	1	2	0	0	409	473
13 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	345	76	23	11	48	1	4	2	9	9	39	398	421
14 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	283	46	25	12	48	0	0	1	4	12	48	304	329
15 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Permet	157	84	27	14	52	0	0	6	22	7	26	214	241
16 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	328	109	133	123	92	1	1	5	4	4	3	304	437
17 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	104	16	21	20	95	0	0	0	0	1	5	99	120
18 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder	319	30	22	20	91	0	0	0	0	2	9	327	349
19 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	176	16	22	20	91	0	0	0	0	2	9	170	192
20 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë	359	67	22	21	95	0	0	0	0	1	5	400	422
21 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	127	124	24	20	83	1	4	1	4	2	8	227	251
22 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë	79	35	54	54	100	0	0	0	0	0	0	60	114
TOTALI ÇËSHTIET CIVILE	23886	5492	3398	2567	76	56	2	184	5	591	17	25860	29378



STATISTIKAT PËR ÇESHTJET E APELIT NGA GJYKATA E SHKALLËS SË PARË (ÇESHTJET E PËRGJITHSHME CIVILE E PENALE)													
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Në prirje të gjyqimit në fillim të periudhës		Çështje të reja të paraqitura në gjykatë		Çështje të gjykuara						Në prirje të gjyqimit në fund të periudhës		Çështje të regjistruara gjithsej
	1	2	Çështje të gjykuara		Lënie në fuqi		Dërguar për rigjykim		Të ndryshuara		Tjetër		
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13		
1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	17123	6974	3670	1819	50	47	1	292	8	1512	41	20427	24097
2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin	932	77	310	206	66	6	2	13	4	85	27	699	1009
3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë	940	115	340	202	59	1	0	20	6	117	34	715	1055
4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	850	136	284	160	56	1	0	22	8	101	36	702	986
5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Diber	1116	144	343	240	70	5	1	27	8	71	21	917	1260
6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres	1609	660	384	260	68	3	1	38	10	83	22	1885	2269
7 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	878	357	399	335	84	0	0	16	4	48	12	1296	1235
8 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë	508	149	155	126	81	0	0	6	4	23	15	502	657
9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	3171	936	561	476	85	10	2	28	5	47	8	3546	4107
10 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	1545	712	286	204	71	3	1	22	8	57	20	1971	2257
11 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje	626	128	201	173	86	1	0	17	4	23	11	533	754
12 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	626	237	214	172	80	0	0	14	7	28	13	649	863
13 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	437	185	161	118	73	2	1	11	7	30	19	461	622
14 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	377	109	145	113	78	0	0	5	3	27	19	341	486
15 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Permet	170	96	42	24	57	0	0	7	17	11	26	224	266
16 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korce	600	268	323	252	78	3	1	21	7	47	15	545	888
17 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	215	55	82	62	76	1	1	9	11	10	12	188	270
18 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder	837	283	99	40	40	4	4	14	14	41	41	1021	1120
19 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	311	186	73	26	36	1	1	13	18	33	45	424	497
20 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë	422	79	29	25	86	0	0	3	10	1	3	472	501
21 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	289	211	53	31	58	2	4	3	6	17	32	447	500
22 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë	149	49	61	60	98	0	0	1	2	0	0	137	198
TOTALI ÇESHTJEVE CIVILE DHE PENALE	33731	12146	8215	5124	62	90	1	589	7	2412	29	37662	45877



3. NGARKESA ME ÇËSHTJE PËR GJYQTAR

Trupa gjykuese është e paplotësuar sipas numërit të gjyqtarëve që janë të caktuar në organikë dhe ngelet imediate rritja e numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate për shkak të ngarkesës shumë të lartë të punës.

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara (RELATOR)	Nr. çështjeve të gjykuara (ANËTAR)
1.	Valdete Hoxha	224	260
2.	Edlira Petri	315	327
3.	Arta Duka	290	313
4	Genti Shala	295	313
5	Astrit Kalaja	275	281
6	Elona Toro	535	543
7	Fatri Islamaj	343	275
8	Alma Ahmeti	385	537
9	Marsela Dervishi	455	376
10	Ornela Naqellari	396	440
11	Irida Kacerja	354	323
12	Elona Mihali	374	280
13	Emona Muci	309	289
14	Lutfije Celami	382	296
15	Dritan Hasani	407	247
16	Fuat Vjerdha	313	282
17	Genti Dokollari	412	256
18	Iliba Bezati	473	502
19	Irena Brahimi	241	277
20	Miranda Andoni	282	356
21	Sokol Pina	416	400
22	Valbon Çekrezi	168	125
23	Valbona Vata	355	337
24	Vojsava Osmanaj	139	91
25	Alma Kolgjoka	26	29
26	Qemal Zaimi	30	109
27	Marsela Pepi	16	30
28	Brikena Ukperaj	5	19
TOTALI		8215	7913

Shpërndarja e ngarkesës së gjyqtarëve është pothuajse e barabartë pasi realizohet vetëm nëpërmjet shortit elektronik. Nga analiza e të dhënave evidentohet fakti se ngarkesa e gjyqtarëve me çështje e kalon dukshëm ngarkesën mesatare që duhet të ketë një gjyqtar.

Bazuar në një llogari mesatare të ngarkesës për gjyqtar, duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2023 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës, rezulton një mesatare prej 357 çështje të shqyrtuara për gjyqtar si relator.

Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën shumë të lartë në punë për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Raporti mbi numrin e çështjeve për çdo gjyqtar (Case for Judge), llogaritet duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2023 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës;

$$\frac{12.146 \text{ (numri total i çështjeve të regjistruara në vitin 2023)}}{23 \text{ (numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2023)}} = 528.08 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$$

Raporti mbi numrin e çështjeve të gjykuara për çdo gjyqtar rezulton si me poshtë;

$$\frac{8.215 \text{ (numri total i çështjeve të gjykuara në vitin 2023)}}{23 \text{ (numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2023)}} = 357.17 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$$

Ngarkesa e lartë e numrit të çështjeve të përfunduara për gjyqtar ka ndikuar në afatin e arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe si rrjedhojë edhe në kryerjen me vonesë të veprimeve administrative lidhur me komunikimin e vendimeve.

a.Delegimet e gjyqtarëve

Gjatë vitit 2023, gjyqtarët e Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë deleguar për të gjykuar çështje në Gjykatën e Posacme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në total janë deleguar 15 gjyqtar për gjykimin e 24 çështje penale.

Delegimet sipas natyres se ceshtjeve	Numri i delegimeve në vitin 2023
Penale	24
Kryesues	6
Antar	18

Për muajin Janar 2023 nga Gjykata e Apelit janë gjykuar çështjet sipas tabelave:

1.GJYKATA E APELIT TIRANË

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara
1.	Fatri Islamaj	13
2.	Edlira Petri	16
3.	Valdete Hoxha	9
4	Genti Shala	9
5	Alma Ahmeti	28
6	Emona Muci	11
7	Elona Toro	0
8	Marsela Dervishi	45
9	Elona Mihali	32
10	Ornela Naqellari	24
11	Irida Kacerja	6
12	Lutfije Celami	31
TOTALI		224

2.GJYKATA E APELIT VLORË

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara
1.	Iliba Bezati	26
2.	Genti Dokollari	38
3.	Laurent Fuçia	50
4.	Adelajda Gjuzi	15
TOTALI		129

3.GJYKATA E APELIT SHKODËR

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara
1.	Fuat Vjerdha	17
2.	Astrit Kalaja	23
3.	Valbona Vata	14
4.	Tonin Sterkaj	17
5.	Vojsava Osmanaj	10
TOTALI		81

4.GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara
1.	Irena Brahimi	6
2.	Miranda Andoni	9
3.	Arben Dosti	2
TOTALI		17

5.GJYKATA E APELIT KORÇË

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara
1.	Arta Duka	16
2.	Dritan Hasani	18
TOTALI		34

6.GJYKATA E APELIT DURRËS


Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara
1.	Valbon Çekrezi	23
2.	Anita Mici	38
3.	Sokol Pina	24
4.	Markelian Koça	24
TOTALI		109

4.VJETERSIA E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TE GJYKIMIT


Raporti i Vjetersis të çështjeve në pritje të gjykimit për çështjet penale dhe civile, deri më datën 31.12.2023.

VJETËRSIA E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT													
Lloji i çështjes	NUMRI I ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT						PËRQINDJA E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT						
	Në pritje të gjykimit në fund të periudh	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	> 5 vjet	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	> 5 vjet
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
A.	23357	1816	2496	2981	5952	7275	2837	7.77497	10.6863	12.7628	25.4827	31.147	12.146
A.1	19841	1524	1953	2254	5047	6535	2528	7.6810645	9.6432539	11.36031	25.43723	32.9368	12.7413
A.2	979	67	133	174	287	196	122	6.8437181	13.5852391	17.77324	29.31563	20.0204	12.4617
A.3	20	1	3	6	6	2	2	5	15	30	30	10	10
A.4	2517	224	407	547	612	542	185	8.6394835	16.170044	21.73222	24.31466	21.5336	7.35002
B.	2623	266	304	413	603	634	403	10.14111	11.58978	15.7453	22.9889	24.171	15.364
B.1	2585	260	293	401	599	631	401	10.058027	11.334623	15.51257	23.17215	24.4101	15.5126
B.2	35	5	9	12	4	3	2	14.28574	25.714266	34.28571	11.42857	8.5743	5.71429
B.3	3	1	2					33.3333333	66.6666667	0	0	0	0
C.	25980	2082	2800	3394	6555	7909	3240	8.01386	10.77752	13.0639	25.2309	30.443	12.471
D.	11682	1606	2065	2947	2572	1455	1017	13.7476	17.84797	25.2268	22.0168	12.455	8.7057
D.1	8127	1562	2028	1423	1211	1100	803	19.218884	24.953858	17.50954	14.90095	13.5351	9.88064
D.2	1013	26	35	357	286	154	155	2.5666338	3.4550839	35.24185	28.23297	15.2024	15.3011
D.3	2542	18	22	167	1075	201	59	0.7081039	0.8654603	45.90873	42.28354	7.90716	2.32101
D.4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
E.	37682	3688	4885	6341	9127	9364	4257	9.79236	12.97063	16.8366	24.234	24.863	11.303

Raporti i Vjetersisë të çështjeve në pritje të gjykimit për çështjet penale dhe civile, deri më datën 31.12.2023



Raporti i Vjetersis të çështjeve në pritje të gjyqimit për çështjet penale dhe civile, deri më datën 31.12.2023



Nga totali i çështjeve të cilat janë në pritje për gjykim rezulton se një numër shumë i lartë i çështjeve që nuk janë planifikuar për gjykim janë për periudhën 2-3 vjet, 3-5 vjet, dhe me shumë se 5 vjet. Nga tabela kuptohet që afati 2-vjeçar i gjyqimit të çështjeve në apel ka kaluar, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Shkaqet e tejkalimit të afatit 2 – vjeçar është mungesa e gjyqtarëve dhe vakancat që kanë lënë në sistemin e Drejtësisë shkarkimet e gjyqtarëve. Është urgjente shtimi i numrit të gjyqtarëve pranë Gjykatës të Apelit.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) është treguesi që krahason numrin total të çështjeve të pazgjidhura, në fund të periudhës së caktuar, me numrin e çështjeve të zgjidhura, brenda të njëjtës periudhë kohore, raport ky i konvertuar me numër ditësh. Treguesi mat se sa shpejt sistemi gjyqësor i gjykatës punon mbi çështjet e marra që nënkupton kohën

që duhet për përfundimin e një lloj çështjesh të caktuara në gjykatë, në dritën e ritmit të punës në atë gjykatë.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (case disposition time) për çështjet e natyrës penale të themelit është 885.183 ditë

$$DT \text{ penale } 2023 = \frac{\text{Numri i çështjeve ne pritje per gjykim ne 31.12.2023}}{\text{Numri i çështjeve te zgjidhura ne 2023}} \times 365 = \frac{11682}{4817} \times 365 = 885.183$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (case disposition time) për çështjet e natyrës civile të themelit është 2790.670 ditë

$$DT \text{ civile } 2023 = \frac{\text{Numri i çështjeve ne pritje per gjykim ne 31.12.2023}}{\text{Numri i çështjeve te zgjidhura ne 2023}} \times 365 = \frac{25980}{3398} \times 365 = 2790.670$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (case disposition time) për të gjitha çështjet e themelit është 1673.35 dite

$$DT2023 = \frac{\text{Numri i çështjeve ne pritje per gjykim ne 31.12.2023}}{\text{Numri i çështjeve te zgjidhura ne 2023}} \times 365 = \frac{37662}{8215} \times 365 = 1673.35$$

	ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE					TREGUESIT E EFICENCËS				SEANCAT GJYQËSORE	
	Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Të gjykuara	Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	Të regjistruara gjithsej	Norma e likuidimit të çështjeve (%)	Koha deri në zgjidhjen e një çështjeje (ditë)	Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund periudhës	% e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet	Numri i seancave gjyqësore	Numri i seancave gjyqësore për çështje
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Çështje civile	23886	5492	3398	25980	29378	62	2791	17280	67	3914	1
Çështje penale	9845	6654	4817	11682	16499	72	885	5750	49	7537	2
GJITHSEJ (A+B)	33731	12146	8215	37662	45877	68 (mes)	1838 (mes)	23030	61 (mes)	11451	1

Nga statistika rezulton se janë zhvilluar 11451 seanca gjyqësore.

Raporti për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio

**RAPORT PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT TË REGJISTRIMIT AUDIO PËR
PERIUDHËN 01.02.2023-31.12.2023**

Nr	Gjyqtar	Seanca të regjistrimit audio (SA)	Seanca të paregjistruara (SP)	Arsyja e mos-regjistrimit	Giithsei (TOT)	Në % (SA/TOT *100)
1	Alma Ahmeti	168	194	0	194	86.60%
2	Alma Kolgjoka	17	17	3	20	85.00%
3	Arta Duka	164	168	0	168	97.60%
4	Astrit Kalaja	147	194	6	200	73.50%
5	Brikena Ukperaj	15	17	0	17	88.20%
6	Dritan Hasani	240	318	1	319	75.20%
7	Edlira Petri	231	269	0	269	85.90%
8	Elona Mihali	155	237	0	237	65.40%
9	Elona Toro	200	212	32	244	82.00%
10	Emona Muci	131	162	2	164	79.90%
11	Fatri Islamaj	158	168	0	168	94.00%
12	Fuat Vjerdha	252	263	0	263	95.80%
13	Genti Dokollari	225	219	28	247	91.10%
14	Genti Shala	192	220	13	233	82.40%
15	Iliba Bezati	218	241	0	241	90.50%
16	Irena Brahimi	148	226	0	226	65.50%
17	Irida Kacerja	149	308	0	308	48.40%

18	Lutfije Celami	171	215	2	217	78.80%
19	Marsela Dervishi	136	144	64	208	65.40%
20	Marsela Pepi	22	24	0	24	91.70%
21	Miranda Andoni	136	146	9	155	87.70%
22	Ornela Naqellari	188	208	22	230	81.70%
23	Qemal Zaimi	16	42	0	42	38.10%
24	Sokol Pina	282	295	0	295	95.60%
25	Valbona Vata	237	247	0	247	96.00%
26	Valdete Hoxha	76	122	10	132	57.60%
	Totali	4074	4876	192	5068	80.40%




Figura 10-Përdorimi i Sistemit Audio

Përqindja e seancave të zhvilluara me mjete audio	80.40%
Përqindja e seancave jo audio	19.60%

Siç shihet edhe nga kjo tabelë, janë zhvilluar 80.40 % e seancave gjyqësore në audio. Ky tregues nuk përfshin numrin e çështjeve për të cilat ligji parashikon zhvillimin në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, përjashtimin e gjyqtarit për çështjet civile dhe penale, urdhrat e ekzekutimit etj, të cilat nuk janë mbajtur në sistem audio. Në sistem audio, janë mbajtur të gjitha çështjet e tjera të gjykuara në Gjykatë. Në sajë të sistemit të regjistrimit audio të seancave (RDA), seancat gjyqësore janë zhvilluar në cdo rast të 7 (shtatë) sallat e gjyqit që ka gjykata dhe janë regjistruar audio. Përjashtim nga ky rregull përbëjnë rastet e seancave për shqyrtimin e kërkesave penale me karakter sekret, apo shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi.

Nëpunësit e administratës, sekretarisë gjyqësore të emëruar gjatë viti 2023, janë trajnuar për përdorimin e sistemit audio, dhe kanë realizuar edhe transkriptimet e procesverbaleve të seancave gjyqësore audio, kur është kërkuar nga pala, si dhe janë zbatuar procedurat e dhënies së kopjeve të regjistrimit audio për palët. Zbatimi i këtij sistemi ka rritur ndjeshëm transparencën e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim.

Një pengesë të konsiderueshme në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2023 përbën sistemi i shërbimeve postare të njoftimeve, mungesa e një sistemi të saktë adresash, mungesa e njohurive procedurale të punonjësve të postës që kryejnë njoftimet për llogari të Gjykatës. Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë mosparaqitja e palëve në gjykim, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër, etj. Edhe përfaqësuesit ligjor të palëve kërkojnë në shumë rastë shtyrje seance, për shkak të paaftësisë të shoqëruar me raport mjekësor/ në gjykime të tjera.

Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikon në shpejtësinë e gjykimit është ngarkesa shumë e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës. Shkaqet e shtyrjes së seancave dhe zhvillimit të seancave joproductive luajnë një rol të rëndësishëm në shpejtësinë e gjykimit.


5.KONTROLLI I VENDIMARRJES NGA GJYKATA E LARTË:

Për vitin 2023, në regjistrin e rekurseve janë regjistruar total 1000 rekurse, të çështjeve civile dhe penale. Në cdo rast për çështjet civile, gjyqtari merr paraprakisht vendimin lidhur me pranimin/ mospranimin e rekursit.

Nga Gjykata e Lartë, për vitin 2023, janë kthyer për rigjykim 465 çështje civile dhe 18 dosje penale, të cilat janë regjistruar dhe janë shortuar.

6.KËRKESAT HEQJE DORË NGA GJYKIMI I ÇËSHTJEVE

<i>Nr.</i>	<i>Zv/krtetar (Gjyqtari)</i>	<i>Miratime</i>	<i>Refuzime</i>
1	Alma Ahmeti	3	2
2	Alma Kolgjoka	1	
3	Arta Duka	4	1
4	Astrit Kalaja	8	1
5	Dritan Hasani	11	1
6	Edlira Petri	8	----
7	Elona Mihali	3	2
8	Elona Toro	8	2
9	Emona Muçi	10	5
10	Fatri Islamaj	10	1
11	Fuat Vjerdha	5	---
12	Genti Dokollari	11	3
13	Genti Shala	4	1
14	Iliba Bezati	9	4
15	Irena Brahimi	15	2
16	Irida Kacerja	11	5
17	Luftije Celami	7	---
18	Marsela Dervishi	2	---
19	Miranda Andoni	5	1
20	Ornela Naqellari	1	1
21	Sokol Pina	1	1
22	Valbon Çekrezi	3	---
23	Valdete Hoxha	9	1
24	Vojsava Osmanaj	4	---
	TOTAL	153	34



Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat çënohet paanësia dhe parashikimit në ligj të mosshqyrtimit të një çështje nga gjyqtari që më parë ka gjykuar një çështje tjetër të caktuar. Pjesë tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi por më e pakët lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze njëanshëmrisë.

KËRKESAT PËR HEQJE DORË TË KRYETARËVE/ZV.KRYETARËVE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE


Nr.	Gjykata përkatëse	Zv/kryetar (Gjyqtari)	Miratime	Refuzime	Totali
1	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Matilda Fetau	10	3	
2	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	Matilda Llangozi	2	1	
3	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	Olkeda Lice	7	5	
4	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	Artan Çupi	5	---	
5	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Enkel Peza	8	6	
6	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Sokol Shehu	7	----	
7	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	Artan Hajredinaj	9	----	
		Aurel Arani	4	5	
8	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë	Alma Kolgjoka	5	1	
9	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	Suela Xhani	3	2	
		Alban Vecani	1	---	
10	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	Suela Dashi	8	1	

11	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	Merita Karaj	4	2	
12	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	Paulin Çera	2	---	
13	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin	Aurel Arapi	5	1	
14	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë	Entela Shedula	2	---	
15	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë	Esmeralda Xhili	2	----	
		Ersida Baigora	3	----	
16	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Flamur Kapllani	1	1	
17	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	Besnik Shehu	1	---	
		Ervin Sulai	4	---	
18	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet	Marjola Beluli	1	1	
19	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë	Enkeleda Dalipi	1	----	
20	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër	Nertila Kape	4	----	
		Xhevdet Lika	1	----	
21	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Artan Jahollari	3	4	
TOTALI			103	30	

7. PËRJASHTIMET E GJYQTARËVE NGA GJYKIMII I ÇËSHTJEVE

Çështje civile dhe penale

Kërkesa për përjashtim gjyqtari	VITI 2023
Pranim	3
Pushuar	2
Rrëzim	23
Mospranim	2
Totali	30



Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për përjashtimin e gjytarëve vërehet se shkaku kryesor i pramit të kërkesës për përjashtim është garantimi edhe në dukje i paanshmërisë së gjyqtarit. Shkaku i pushimit të kërkesave për përjashtim gjyqtari është shqyrtimi dhe pranimi i kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi. Ndërsa shkaqet kryesore të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj si dhe mosdepozitimit i akteve për të provuar ekzistencës e arsyeve të njëanshmërisë.

III MENAXHIMI I LËVIZJEVE TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE


1.Mbikqyrja e progresit te çështjeve

- Në vazhdimësi gjatë vitit 2023 ka patur bahskëpunim dhe mbështetje nga drejtuesi i Prokurorisë të Apelit, për implementimin e masave që lidheshin me reduktimin e kërkesave për shtyrje të gjykimit, etj.
- Edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ka vazhduar bashkëpunimi për masat e ndërmarra në kaudër të palnit të veprimit sic janë: Paraqitja e dokumentave të kërkuara përpara seancës, komunikimi i shpejt me gjykatën edhe në rrugë elektronike, etj.
- Keshilli i Gjykatës ka kryer takime me përdoruesit e gjykates sic janë avokate, prokuror, shërbimi postar, individ.

IV. MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS

1. Organika dhe burimet njerëzore

Organigrama e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm -Tiranë 245



Me vendimin nr.1, datë 04.01.2023, Këshilli i Gjykatës të Apelit Tiranë ka vendosur “Miratimin e Struktues, Organikës dhe pershkrimet e punes te Gjykates të Apelit te Juridiksionit të Përgjithshëm

Gjatë muajit Janar 2023, Këshilli i Gjykatës të Apelit Tiranë, ka marr vendime lidhur me propozimet e Komisionit të Ristrukturimit për 5 (pesë) Gjykata Apeli, duke vendosur:

-Transferimin e nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës të Apelit Korçë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

-Transferimin e nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës të Apelit Gjirokastrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

-Transferimin e nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës të Apelit Vlorë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

-Transferimin e nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës të Apelit Durrës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

--Transferimin e nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës të Apelit Shkodër në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2023, në muajin Janar janë zhvilluar 10 mbledhje Këshilli të Gjykatës dhe gjithë periudhën tjetër janë zhvilluar edhe 37 mbledhje këshilli.

Duke qenë se Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është gjykata e vetme në Republikën e Shqipërisë, në rang Apeli, për juridiksionin e përgjithshëm (civil dhe penal), në organikë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka një staf prej 245 punonjësish. Numri faktik është më i vogël, për shkak të largimeve të gjyqtarëve nga procesi i vetingut dhe mosplotësimit të gjykatës me gjyqtarë dhe me ndihmësa ligjorë, Në organikën e Gjykatës për vitin 2023, ka qenë një mesatare prej 23 gjyqtarësh, nga 78 që parashikon organika. Ndihmësa ligjor 20, Kancelar 1 (një), K/Sekretar 2 (dy), sekretarë gjyqësorë 35, nga të cilat regjistruer 5 (pesë), 2 civil dhe 3 penal, 1 (një) nëpunës IT, 1 (një) arkivë, 1 (një) protokoll, 1 Specialist me Media me Publikun, 1 specialsit statistike, 1 Drejtor Drejtorie Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, 2 specialist buxheti, 1 specialsit finance, 1 specialsi burime njerezore, 1 specialsit mbeshtetes, 18 (shërbime mbështetës, ftues, nëpunës gjyqësor, mirembajtës, shofer, roje, sanitar), 1 shef sektori Sektori i Kordinimit te Zyrave te Sherbimeve dhe Protokoll/Arkive.

Gjatë vitit 2023, janë shpallur vëndet vakante për sekretar gjyqësor , në total 25 nga të cilat janë plotësuar 17 me lëvizje paralele dhe 8 me procedure pranim në shërbimin civil gjyqësor.

2.Sistemi elektronik i menaxhimit te ceshtjeve gjyqesore

Në Gjykatën e Apelit që prej vitit 2007 aplikohet sistemit elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS).Pavarsisht problematikave të evidentuara në mënyrë të vazhdueshme për funksionimin e këtij sistemi dhe disa zgjidhje të ofruara në vijimësi, ende mbeten për zgjidhje disa problematika, ku ndër më kryesorët renditen:

- dosjet e pambyllura ne sistem vazhdojnë të jenë problematike në evidentimin e saktë të ngarkesës së gjyqtarëve. Numri i dojeve që nuk janë mbyllur në sistem e kalojne shifrën 20 mijë .
- migrimi i databazave të gjykatave të tjera ka sjellë problem në dublikimin e përdoruesve të gjyqtareve , por që me ndihmën e kompanisë kontraktore një pjesë e madhe e këtij problemi është korrektuar.
- mosgjenerimi i të dhënave statistikore dhe raporteve të tjera të sakta dhe sipas modelit të kërkuar, në funksion të statistikave të kërkuara nga Këshilli i Lratë Gjyqësor, Ministrria e Drejtësisë.

- moskryerja e një sër funksionesh, si mosëpërjashtimi automatik nga gjykimi në themel i çështjes i gjyqtarëve që kanë shqyrtuar kërkesat në fazën e hetimeve dhe në seancë paraprake njëkohësisht, pa qenë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera nga përdoruesi si rishortimi i çështjes,etj.
- Pajisjet kompjuterike me të cilat punojnë gjyqtarët dhe stafi janë prodhim i vitit 2011 deri në vitin 2023. Në gjykatë punohet kryesisht më programin Ëord 2013-2016 , me kompjutera kryesor ACER, HP, FUJITSU. Programet që përdorin stafi i gjykatës në përgjithësi është i kategorizuar si më poshtë:

Tabela 17: Niveli i programeve kompjuterike të përdorura në gjykatë

	Programet	+ 100% e gjyqtarëve
Asistencë e drejtpërdrejtë përgjyqtarin/nëpunësin e gjykatës	Përpunimi në paketën Microsoft Office	?
	Baza e të dhënave elektronike të jurisprudencës	
	Dosje elektronike (CCMIS)	
	Lidhje me internet	?
Administrim dhe menaxhim	Sistemi i regjistrimit të çështjeve (CCMIS)	?
	Sistemi i informacionit të menaxhimit të gjykatës (CCMIS)	?
	Sistemi i informacionit financiar (Alfa Ëeb)	?
Sistemi Audio	FTR AUDIO SYSTEM	?
Komunikim ndërmjet gjykatës dhe palëve	Formularë elektronikë	?
	Faqe zyrtare e gjykatës ³	?
	Koordinatori për të drejtën e Informimit Email-et e informacionit	?

Përveç punëve rutinë, zyra e IT-së, gjatë vitit 2023, është përballur me lëvizjet e shumta të gjyqtarëve (si atyre që kanë ikur edhe atyre që kanë ardhur të rinj) të cilat janë shoqëruar me lëvizje dosjesh dhe rishpërndarje ndërmjet gjyqtarëve. Zyra e IT-së ka asistuar Këshillin e Gjykatës në shpërndarjen e dosjeve në mënyrë sa më të balancuar dhe transparente ndërmjet gjyqtarëve ekzistues dhe atyre të rinj. Janë ndërtuar tabelat e ngarkesës së gjyqtarëve të kategorizuara në vite dhe në objekt në mënyrë që ngarkesa e dosjeve të shpërndahet sa më drejtë.

Gjatë vitit 2023 ka pasur një shtim të organikës së punonjësve, si rrjedhojë janë shtuar dhe detyrat e sektorit të IT-së për të përshtatur infrastrukturën e duhur kompjuterike që të ju mundësojë punonjësve aksesin në sistemet elektronike të gjykatës . Me shtimin e stafit të gjykatës ka lindur dhe nevoja për bazën materiale kompjuterike dhe të netëorkut ku shpesh në mungesë të pajisjeve elektronike jemi detyruar të përdorim pajisje të vjetra dhe jo shume efektive. Vlen të përmendet që dhoma e serverit është jashtë standartit të duhur për një dhomë serveri ,ku vazhdimisht është kërkuar ndërhyrja emergjente në investimin e një dhome serveri që plotëson parametrat e duhura të sigurisë. Gjithashtu dhe rrjeti kompjuterik dhe elektrik është i mbingarkuar dhe ka nevojë për një remont total të tyre. Një problem shqetësues është dhe mosfunksionimi i lidhjes me VPN nga qendra tek njësitë e shërbimeve në rrethe , e cila sjell probleme në shërbimin e palëve të interesuara .

Shorti elektronik;

Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS mundëson përveç të tjerash ndarjen e çështjeve mes gjyqtarëve, me short elektronik. Këtu duam të theksojmë që prej datës 01.02.2023, me short elektronik bëhet edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm sipas listës së gadishmërisë. Kërkesat e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 55 datë 29.12.2022” Për procedurat e ndarjes së çështjeve me short”, janë respektuar në mënyrë rigorozë në lidhje me ndarjen e çështjeve me short si dhe është rritur transparencja e këtij procesi, duke u publikuar paraprakisht koha e realizimit të shortit, duke u garantuar pjesëmarrja e publikut, si dhe duke u afishuar online në faqen zyrtare të gjykatës. Nëpërmjet përcaktimit të vendit të zhvillimit të shortit dhe rishortimit në sallën e gjykatës, të pajisur me monitor, është rritur aksesin nga pjesëmarrës të tjerë të interesuar si palët, avokatët mbrojtës, media. Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet janë shpërndarë në mënyrë pothuajse të barabartë për të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë edhe numrin e çështjeve të regjistruara gjatë gadishmërisë, të cilat shortohen elektronikisht midis gjyqtarëve të gatshëm.

Shorti elektronik është hedhur çdo ditë , në orën 14:30 në sallën e gjyqimit dhe të nesërmen është shpërndarë tek gjyqtarët relator.

Për vitin 2023 janë rishortuar dosjet gjyqësore të gjyqtarëve të emëruar në gjykatën e Lartë, të 1 (një) gjyqtari të shkarkuar, dhe të një gjyqtari të emëruar anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor (në zbatim të vendimeve të Këshillit të Gjykatës)

III. PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Programi i transparencës për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është publikuar dhe përditësuar në faqen zyrtare të gjykatës. Gjykata e Apelit ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik.


3.Ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore

Kryesekretaria, sekretaria gjyqësore kanë përballuar një volum shumë të lartë pune, duke regjistruar në total 12.146 dosje gjyqësore si dhe janë kryer komunikimet e vendimeve gjyqësore të arsyetuara, si dhe rekurseve të paraqitura për to. Në total në Gjykatën e Lartë janë dërguar 1110 dosje gjyqësore, kurse pjesa tjetër pas komunikimit të vendimi është dërguar në Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ka patur një numër të lartë kërkesash për shërbim nga arkiva e Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe nga arkiva e zyrave të shërbimit, për vënien në dispozicion të një kopje të dokumentave arkivore, vendimeve që ndodhen në arkivë, apo informacione të tjera arkivore. Nga ana jonë qytetarëve i është shërbyer në një kohë të shkurtër dhe jo vetëm në Tiranë, por edhe në zyrat e shërbimeve. Kërkesat janë shqyrtuar dhe ju është dhënë përgjigje brenda afatit ligjor. Probematik vijon të mbetet mungesa e hapësirave të nevojshme për sistemimin e dosjeve gjyqesore dhe arkivimin e tyre në ambientet e gjykatës.

Numri i kërkesave drejtuar arkivës

TIRANE	4398
DURRËS	458
VLORE	306
SHKODËR	374
GJIROKASTËR	283
KORCE	110



4.Akresi, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median Akresi, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe Median

- Gjatë vitit 2023, në drejtim të rritjes të transparencës dhe aksesit në drejtësi, ka vijuar aksesi nëpërmjet pajisjes “ Infopoint” të vendosur në hollin e gjykatës. Nëpërmjet pajisjes “ Infopoint” publiku, avokatet, përfaqësuesit ose palet kanë mundësi të marrin informacion në kohë reale nga faqja zyrtare e internetit të gjykatës ose sistemi i gjykatës në çdo kohë pa patur nevojë të pyesin apo të presin në radhë tek zyra e informacionit
- Gjatë vitit 2023 ka patur një numër shumë të lartë, kërkesa për informacion dhe nga ana e Zëvënsës Kryetarit dhe Kancelarit janë trajtuar rreth 7.000 shkresa me kthim përgjigje.

- Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nëpërmjet pasqyrit të tij në faqen zyrtare të gjykatës së Apelit, pranë portalit www.gjykata.gov.al. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik. Në raport me median gjykata ka treguar bashkëpunim të vazhdueshëm, i cili rezulton se ka qenë në nivelin e duhur, duke komunikuar sipas rastit në lidhje me informacione apo seanca gjyqësore për të cilat publiku ka patur interes. Në këto raste media apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve elektronike, grupit të WhatsApp si dhe në raste të tjera të veçanta më kërkese të tyre është mundësuar prezenca në seancat gjyqësore publike duke mbajtur shënime apo dhe pamje filmike. Rezulton se është kryer një punë e mirë për informimin dhe sensibilizimin e avokatëve, palëve ndërgjyqëse dhe qytetarëve për marrjen e informacionit mbi shortin dhe planifikimet e seancave gjyqësore nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të gjykatës në internet. Edhe gjatë vitit 2023, publiku ka patur akses në *InfoPoint*, që ndodhet në hollin e gjykatës, pranë hyrjes së publikut, ku ka marrë informacion mbi shortin, si dhe informacione mbi çështjen ku është palë ndërgjyqëse. Në mënyrë të rregullt dhe me mjaft efikasitet komunikimi i brendshëm kryhet në kohë reale, kjo falë përdorimit dhe funksionimit të e-mail-it zyrtar, nëpërmjet të cilit zyra e personelit bashkëvepron me administratën (gjyqtarë + administratë) dhe çdo informacion përcillet në kohë reale duke lehtësuar komunikimin, pakësuar kostot për kancelari (letër, bojë, etj.). Zyra e personelit është angazhuar që çdo vendim/urdhër t’i komunikohet sipas rëndësisë trupës gjyqësore, administratës dhe të afishohet në faqen zyrtare eeb të institucionit.
- Tashmë përdorimi i aplikacionit elektronik social i dedikuar komunikimeve zyrtare (WhatsApp), për njoftimet e shpejta e sidomos ato në grup, për vetë ritmin e punës që kërkon Gjykata, nuk është më një risi, por është kthyer në një domosdoshmëri për administratën dhe trupën gjyqësore.
- Një tjetër bashkëpunim shumë i ngushtë i gjykatës është edhe me Shkollën e Magjistraturës, në mbajtjen e një korrespondence të rregullt në lidhje me kryerjen e praktikës paraprofesionale dhe profesionale të kandidatëve për magjistratë si dhe me trajnimet për gjyqtarët, kancelarin dhe ndihmësat ligjorë.
- Bashkëpunimi me publikun dhe median është trajtuar me përparësi nga zyra e personelit duke i dhënë rëndësinë e duhur për të vënë në dukje jo vetëm punën e kryer të institucionit, por duke u parë si mundësi për të na ndihmuar për të evidentuar mangësitë, si dhe për të ndryshuar qasjen e publikut me gjyqësorin, gjyqtarëve me median, pakësimin e problematikave dhe rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj gjyqësorit.
- Nëpërmjet kësaj zyrë janë kryer të gjitha komunikimet me gazetarët e mediave vizive dhe shtypit të shkruar. Komunikimi ka qenë interaktiv, i përditshëm dhe në kohë reale. Informacioni i nevojshëm i është dhënë gazetarëve në formë të shkruar në rastet kur kërkimi i tyre është parashtruar me shkrim, në formatin elektronik, duke përdorur email-in zyrtar të institucionit, si dhe më masivisht ky komunikim kryhet nëpërmjet telefonit dhe mesazheve në grup. Gjithashtu sa herë është kërkuar nga gazetarët janë dhënë edhe intervista nga Kancelari i Gjykatës dhe nga Gjyqtari i Medias.
- Bashkëpunimi me gjyqtarin për media, si dhe anëtarin për median pranë Këshillit të Lartë

Gjyqësor, ka qenë i shkëlqyer, duke kontribuar në mënyrë cilësore në trajtimin e kërkesave për informim.

- Me vendimin nr.18, datë 17.06.2021 të Këshillit të Gjykatës së Apelit Tiranë është miratuar propozimi i gjyqarit të medias për një gjykatë të hapur për të gjithë, duke bërë të mundur që e premtja e fundit e çdo muaji, të jetë një ditë e hapur për publikun, që dëshiron të vizitojë Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nga ana e qytetarëve, universiteteve, shkollave, ka patur interes dhe kanë vizituar Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Unifikimi i praktikave për të gjitha gjykatat dhe veçanërisht ofrimi i shërbimeve inovative është një tjetër hap lehtësues për përmirësimin e punës së punonjëses së marrëdhënieve me median dhe publikun brenda gjyqësorit.
- Qëllimi themelor i Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, është sigurimi i një publiku të informuar në një kohë sa më të shpejtë dhe një administratë llogaridhënëse. Këto janë jetike për funksionimin e një shoqërie demokratike dhe paraqiten si domosdoshmëri për të sfiduar korrupsionin dhe për të siguruar përgjegjshmërinë e zyrtarëve. Rritja e besueshmërisë së publikut ndaj sistemit gjyqësor në përgjithësi, si dhe përmirësimi i shërbimeve duke rritur sasinë e informacionit publik është qëllim në vetvete i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Për vitin 2023 rezultojnë të regjistruara gjithsej 18 kërkesa në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke specifikuar se janë regjistruar ato kërkesa që kanë ardhur në respektim të nenit 11, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Por duhet theksuar se pranë zyrës së protokollit gjatë vitit janë protokolluar edhe shumë shkresa/kërkesa me shkrim ose në format elektronik.
- Programi i transparencës është vlerësuar si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e të drejtës për informim.
- Gjatë vitit 2021, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, si dhe Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020, “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”, ka miratuar një version të unifikuar të pasqyrimin të informacionit për çdo institucion si të programit të transparencës, por edhe formatit të kërkesave dhe përgjigjeve.
- Informacioni i bërë publik në seksionin: Programi i Transparencës, por edhe në faqen zyrtare të Gjykatës, synon transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke e pasqyruar në rubrika, tekste/përmbajtje, afate kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.
- Dokumentacioni i bërë publik është i përditësuar në formë e përmbajtje, tek faqja zyrtare e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (gjykata.gov.al). Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, referuar legjislacionit në fuqi.
- Gjykata ka kthyer përgjigje, në rrugë elektronike, dhe ka dhënë orientimet e nevojshme për qytetarët që të mund të drejtohen pa vështirësi në gjykatë për të marrë informacionin e nevojshëm me anë të formularëve elektronikë apo informacionit që gjendet në faqen zyrtare ëeb të gjykatës. Ndërkaq akte të tjera administrative që kanë të bëjnë me procedurat në gjykatë, me karakter të përgjithshëm, janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të gjykatës.

- Publikimi për informim i çdo urdhri të brendshëm të titullarit, si dhe vendimmarrjeve të Këshillit të Gjykatës, me karakter të përgjithshëm të cilat përpilohen në funksion të menaxhimit të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është kryer nën kujdesin e veçantë të koordinatorit për të drejtën e informimit me qëllim rritjen e transparencës, paanësisë së administratës gjyqësore, aktivitetit të saj, rregullimin e brendshëm si dhe shërbimit ndaj publikut.
- Koordinatori për të drejtën e informimit, vazhdon të ketë një nga sfidat më të mëdha zbatimin e udhëzimit nr. 4059/2, datë 07.06.2016, të Ministrit të Drejtësisë *“Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”*, Udhëzimit Nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *“Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”*, si dhe të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, për shkak se ende nuk është ngritur një strukturë e cila do të angazhohet specifikisht me këtë proces pune, por operojmë rast pas rasti.
- Megjithatë, pavarësisht kësaj sfide, Gjykata, nëpërmjet koordinatorit për të drejtën e informimit ka synuar të realizojë, për aq sa ka qenë e mundur, respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që kërkohen, si një e drejtëthemelore në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, e sanksionuar në Kushtetutë dhe në një sërë aktesh të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Gjithashtu, edhe këtë vit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim dhënien e informacionit në kohë sa më reale dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, drejt të gjithë personave të interesuar (kryesisht gazetarë të kronikës) ka vijuar komunikimin në grupin ehat’s up, në të cilin gazetarët adresojnë çështjet për të cilat kërkojnë informacion dhe kanë interes dhe përgjigja iu kthehet në grup, në mënyrë transmetimin e informacionit në të njëjtën kohë.
- Paralelisht, gjykata i është përgjigjur edhe kërkesave të insitucioneve të ndryshme dhe medias. Konkretisht:
 - ▶ Gjykata i është përgjigjur kërkesave të organeve të Vettingut, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me informacion dhe kopje të dosjeve gjyqësore. Gjykatat i është përgjigjur me fotokopje dosjes gjykatave të shkallëve të para dhe prokurorive. Gjykata i është përgjigjur Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ministrisë së Drejtësisë, me informacion dhe të dhëna statistikore të kërkuara në periudha kohore 3 mujore dhe jo vetëm, të dhëna këto voluminoze dhe që, në të shumtën e rasteve, kanë kërkuar punë manuale dhe e gjithë kjo punë është përballuar nga specialisti i statistikave, nën mbikëqyrjen e Kancelarit.
 - ▶ Për vitin 2023 është kryer inspektimi tematik për lirimet me kusht për të gjitha gjykatat e apeleve dhe ne i kemi përgjigjur ILD-së për të gjitha lirimet me kusht edhe të ish gjykatave të Apeleve të rrethve dhe i kemi vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar së bashku me dokumentacionin.
 - ▶ Për vitin 2023 është kryer inspektimi tematik për shortin e vitit 2022 për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm .
 - ▶ Gjykata i është përgjigjur me informacion medias. Komunikimi është interaktiv, i përditshëm dhe kryhet në kohë reale. Medias, Gjykata i është përgjigjur jo vetëm me informacion, por edhe me statistika sipas kërkesave.
 - ▶ Është përballuar një numër shumë i lartë i kërkesave për fotokopje aktesh nga palët/ përfaqësuesit e tyre, e cila ka kërkuar personel dhe kohë.
 - ▶ Gjatë vitit 2023, janë transferuar nga godinat e ish gjykatave të gjitha dosjet gjyqësore penale, të cilat i janë shpërndarë gjyqtarëve relator. Në këto godina ka ende 4530 dosje civile dhe konkretisht në zyrën e Shërbimit Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Kjo për shkak të mungesës së hapësirës për arkivin e tyre pranë Godinës në Tiranë

- ▶ Gjatë vitit 2023, ka filluar inventarizimi i dosjeve gjyqësore
- ▶ Gjatë vitit 2023, ka nisur puna për dixhitalizimin e arkivës në gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe në arkivat e zyrave të shërbimeve, në zbatim të shkresës nr.2552/15, datë 19.07.2022 “Program dixhitalizimi i arkivave të gjykatës”
- ▶ Gjatë vitit 2022-2023 është kryer raporti i auditit për periudhën 2018-2022 dhe pas përfundimit të kontrollit na kanë lënë disa rekomandime të sugjeruara nga grupi i auditimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një periudhë 4 vjeçare, me Objekt auditimi: Vlerësimi i funksionit të kontrolleve të brendshme të projektuara dhe vendosura nga menaxhimi i Gjykatës në funksion të realizimit të objektivave të veprimtarisë për periudhën 01.01.2018-30.06.2022. Më dt.23.03.2023 është dërguar raporti përfundimtar, ku në konkluzion të përgjithshëm thuhet shprehimisht: *Gjykata paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e veprimtarisë gjyqësore, marrjen e vendimeve strategjike operationale, mbikëqyrjen e administrimit të riskut dhe kontrolleve për një administrim efektiv të punës organizative dhe përgjegjësie.*

Pra, në tërësinë e tij, menaxhimi administrativ i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke patur parasysh dhe rekomandime të veçanta, të cilat janë në ndjekje dhe zbatim, ka qenë i mire, i vlerësuar në përgjithësi me risk të ulët dhe në raste të pakta me risk të mesëm.

5. Zyrat e Shërbimit

Zyrat e shërbimeve janë hallka të rëndësishme në punën e gjykatës. Ato mundësojnë një komunikim të drejtpërdrejtë e efikas me qytetarët, për të ofruar shërbime administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor pranë qytetarëve. Në kushtet kur tashmë kemi të bëjmë me një gjykatë të vetme apeli në Republikën e Shqipërisë dhe distancën e saj fizike nga qytetarët, këto zyra janë ngritur dhe funksionojnë në Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër. Çdo zyrë shërbimi përbëhet nga të paktën 3 (tre) nëpunës civilë gjyqësorë.

Nëpunësit civilë gjyqësorë që ushtrojnë funksionet pranë zyrave të shërbimeve, marrin në dorëzim dhe përcjellin pa vonesë për trajtim në strukturën qendrore të shërbimeve gjyqësore ose administrative të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, çdo kërkesë ose dokument që paraqitet nga palët në një proces gjyqësor, përfaqësuesit ligjorë, përdoruesit e tjerë të gjykatës si dhe çdo subjekt tjetër i interesuar.

Në kushtet kur ambientet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë qenë të pa përshtatshme dhe pa kapacitetin e duhur, pranë këtyre zyrave është ruajtur një pjesë e arkivit të gjykatës.

6. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR

Me vendimin nr.495, datë 21.10.2020, të KLGJ-së është vendosur krijimi i Njësive të Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatave të Apeleve. Njësia e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është e përbërë nga një numër pozicionesh prej 32 ndihmësash ligjor. Për vitin 2023, janë 20 ndihmës ligjor të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nga zëvendëskryetari është nxjerr urdhëri nr 21 datë 08.02.2023 “Për funksionimin e Njesisë së shërbimit ligjor” ku janë përcaktuar dhe detyrat që do të kryejnë ndihmësit ligjor. Ndhmësit ligjor janë të ndarë sipas trupave gjykues, pra dy ndihmës për një trup gjykues të përberë nga tre gjyqtar, njësia ligjore ka funksionuar duke ndjekur përgatitjen e çështjeve planifikimet mujore të gjyqtarëve dhe udhëzimet e tyre. Me vendimin nr.5, date 03.03.2023 të Këshillit të Gjykatës është miratuar “Formati Standatit në përgatitjen e çështjeve nga njësia e shërbimit ligjor” Përveç punës

së përditëshme për përgatitjen e dosjet gjyqësore që gjyqtarët planifikojnë për gjykim, ndihmësat kanë përfaqësuar gjykatën në të gjitha shkallët e gjykimit në proces gjyqësore. Vetëm për Vitin 2023, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është e paditur në 80 çështje, ku paditës janë gjyqtarët, stafi administrativ.

Numëri i ndihmsave ligjor është shumë i ulët në raport me volumin e punës që duhet të kryejnë.

7. Çështjet e infrastruktures, ruajtjes dhe sigurisë në gjykate

Nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë ushtrimit të detyrës, janë hasur një sërë problematikash, të cilat kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punës në këtë institucion.

Problemi kryesor është godina në të cilën ushtron aktivitetin kjo gjykatë. Kjo godinë është e vjetër, pa sistem qendror kondicionimi, pa ashensorë, gjë që bën të vështirë shpërndarjen e dosjeve nga kryesekretaria të gjyqtarët dhe të arkivi. Mbi të gjitha kjo godinë nuk ofron mjaftueshëm zyra për gjyqtarët dhe stafin e kësaj gjykate. Deri në vitin 2012 kjo godinë ka shërbyer për Gjykatën e Apelit të Tiranës, e cila deri më datën 31.01.2022 ka pasur organikën në total 112 persona, ndërsa në fakt aktivitetin e ushtronin 85 persona. Ndërsa struktura aktuale e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, miratuar me vendimin nr. 555, datë 29.12.2022, përbëhet në total nga 245 punonjës, nga të cilët aktualisht e ushtrojnë detyrën 143 punonjës, pra 58 punonjës më shumë.

Aktualisht në godinë ftuesit, punonjësit e sigurisë dhe sanitaret nuk kanë ambiente ku të qëndrojnë. Ndihmësit ligjor punojnë në kushte jo normale, ku në një sallë punojnë 10 ndihmësa ligjor, ndërsa në një zyrë tjetër të vogël 5 ndihmësa. Pjesa tjetër e ndihmësave punojnë në ambiente të përshtatura për ta që nuk ofrojnë kushte komode pune. Dhe sekretaret janë të detyruara të rrinë ngushtë, në ambiente të përshtatura për to. Po kështu nuk ka ambiente për magazinën. Fotokopjet dhe mjete të tjera pune qëndrojnë në korridorët e institucionit.

Zyrat e gjyqtarëve janë të vogla, një pjesë e sipërfaqes së zyrës e zënë dosjet gjyqësore, dhe pa paradhoma të përshtatshme.

Godinës i mungojnë ambientet e duhura për arkivimin e dosjeve gjyqësore. Jemi detyruar që një pjesë të dosjeve t'i magazinohet pranë zyrave të shërbimit nëpër rrethe, pasi ka qenë e pamundur mbajtja e tyre në ambientet e gjykatës. Po kështu problem ka qenë dhe sistemi kompjuterik i gjykatës i cili ka qenë tejet i amortizuar dhe sillte pengesa serioze në zhvillimin normal të punës. Për vitin 2023, pas kërkesave të përsëritura nga ana jonë, u miratua fondi përkatës për arkivin dhe sistemin kompjuterik, duke zgjidhur përfundimisht këto probleme, të cilat duhet të ishin zgjidhur kohë më parë.

Me shkresën nr.198 prot, datë 12.01.2023 i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesë për rrafte lëvizës për katin nëntokë (bodrum), por kjo kërkesë është miratuar fund të vitit 2023.

Për garantimin e rregullit të sigurisë në Gjykatë i jemi drejtuar Këshilli të Lartë Gjyqësor për të na mundësuar një fond për instalimin e një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme, por kjo kërkesë nuk është miratuar

Për marrjen e masave organizative për alokim fondesh për investim për plotesimin e nevojave për rikonstruksion të dhomës të serverit i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, por ende nuk na është miratuar

- Për garantimin e rregullit të sigurisë në Gjykatë është imediate instalimi i një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme.
- Për marrjen e masave organizative për alokim fondesh për investim për plotesimin e nevojave për rikonstruksion të dhomës të serverit.

8. Analiza e realizimit të fondeve buxhetore të vitit 2023

Nga buxheti i shtetit për vitin 2023, nëpërmjet KLGJ-së është akorduar fondi total si më poshtë:

	Po	Shuma/000 (lekë)	
Buxheti vjetor i alokuar për pagat		384.018	
Buxheti vjetor i alokuar për sigurimet shoqërore		36.100	
Buxheti vjetor i alokuar për shpenzimet operative		72.776	
Buxheti vjetor i alokuar për rikonstruksion te plote, pajisje elektronike dhe pajisje mobilje (investime)		5.060	
Buxheti vjetor për Projekt		0	
Buxheti vjetor i alokuar për individë (dalje në pension, rast fatkeqësi familjare)		316,33	

Në fondin e pagave prej 384.018 mijë lekë, vlen për tu theksuar fakti që janë likuiduar plotësisht diferencat neto të pagave të magistratëve përfshirë këtu diferencat e gjyqtareve të Gjykatave të Apeleve (Durrës, Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë) që lindën nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 22.11.2022 .

INVESTIME

• **Artikulli 231 Investime nga buxheti:**

Plani = 5.060.000 lekë Fakti =4.865.438 (Realizimi 96.15 %)

Me këto fonde janë blerë grila për pjesën më të madhe të zyrave dhe ambienteve të gjykatës në vlerën 520.080 lekë, ndërsa me pjesën tjetër prej 4.345.358 lekë u likuiduan dy situacionet e fundit të rikonstruksionit i cili përfundoi në shkurt të vitit 2023 si dhe kontratat e kolaudimit dhe supervizimit të këtyre punimeve.

Rikonstruksioni total i këtij ambienti ka kushtuar **22.123.197** lekë me TVSH.


Në fondet buxhetore për investime në vitin 2024 përveç fondeve për rafte arkive, janë alokuar edhe fonde për rikonstruksionin e rrjetit elektrik dhe kompjuterik të godinës.

SHPENZIME OPERATIVE

- Artikulli 602 shpenzime operative nga buxheti.

Plani = 72.776.006 lekë Fakti = 60.303.143 lekë (Realizimi 83 %)

Janar - Dhjetor Viti 2023				ne %	
Lloji i shpenzimit	Buxhet	Të ardhurat e institucionit	Totali	me buxhet	të ardhura
Ekspertë	310	0	310	0.964 %	
Psikologe/ Përkthyes	693	0	693	2.156%	
Avokatë kryesisht	4.652	0	4.652	14.47%	
Posta dhe shërbimi korrier	5.265	0	5.265	16.38%	
Letër/ kancelari	2.857	0	2.857	8.88 %	
Ekzekutim vendime gjyqësore	18.364	0	18.364	57.14%	
Totali	32.141		32.141	100%	



Përsa i përket zërave të tjerë të shpenzimeve operative edhe ato kanë pësuar një rritje të dukshme duke qenë se janë shtuar edhe 5 zyrat e shërbimeve në rrethe, janë furnizuar me bazë materiale si kancelari, shtypshkrime, apo bojë për printerin si dhe janë paguar shpenzimet e ujit, dritave, etj.

Zërin më të madh në shpenzimet operative e zënë ekzekutimet e vendimeve gjyqësore, të cilat për vitin buxhetor 2023 kanë qenë të konsiderueshme. Por KLGJ ka alokuar fonde rast pas rasti dhe deri në fund të vitit 2023 ato janë likuiduar tërësisht.

Theksojmë që detyrimet e prapambetura për paga apo shpenzime operative për vitin 2023 janë 0, pra nuk ka detyrime të mbartura për vitin buxhetor 2024.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kryen veprime administrative që konsistojnë në realizimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit publik, konform Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, udhëzimeve në zbatim të tyre, si dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë. E gjithë procedura e një prokurimi realizohet online në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

Për vitin 2023, nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, janë zbatuar procedurat e prokurimeve, me fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka të ardhura dytësore vetëm nga 10 % i pullave të cilat në vit kapin vlerën 87.100 lekë, për çdo nevojë që mund të dali gjatë vitit ushtrimor jemi të detyruar ti kërkojmë KLGJ-së fonde shtesë për mbulimin e tyre.

Në vitin 2024 janë alokuar fonde nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për blerjen e rafteve levizese të arkives dhe për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e rrjetit elektrik dhe kompjuterik të gjitha ambienteve të godines.

OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME

► Objektiva

Analiza vjetore e punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, i shërben stafit të gjykatës, si dhe aktorëve të tjerë që kontribuojnë në dhënien e drejtësisë, për të përcaktuar qartë objektivat për vitet në vijim, për përmirësimin e cilësisë së dhënies së drejtësisë.

Objektivat e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë padyshim rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në dhënien e drejtësisë, si dhe përmirësimi i standardeve, duke u orientuar drejt një gjykatë me një performancë të lartë.

Synimet e institucionit tonë për vitet në vijim janë:

- Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve gjyqësore;
- Rritja e integritetit dhe besueshmërisë në dhënien e drejtësisë;
- Rritja e profesionalizmit dhe transparencës duke ruajtur të dhënat personale;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve, duke synuar dixhitalizimin e disa procesve administrative.
- Rritjen e aksesit dhe trajtimin sa me cilësor të publikut.

Objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm janë:

- Përmirësim i vazhdueshëm i kushteve të punës;
- Evidentimin dhe marrjen e masave, nga Këshilli i Gjykatës, për likuidimin e çështjeve të prapambetura ende në gjykim;
- Përpunimi i dosjeve gjyqësore për ruajtje të përhershme/përkohshme dhe asgjësim;
- Komunikimi me aktorët e tjerë, si Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Realizimi i takimeve periodike me ta, duke analizuar dhe evidentuar problematikat që shqetësojnë gjykatën;
- Rritja e aksesit të përdoruesve të gjykatës, si dhe trajtimi i tyre me drejtësi, barazi dhe respekt;
- Monitorimin e vazhdueshëm të marrëveshjes me Posta Sh.a në lidhje me rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë në lidhje me shërbimin e dokumentacionit gjyqësor;
- Trajnim i duhur për sekretarinë gjyqësore në drejtim të përmirësimit të aftësive kompjuterike, etikës së komunikimit me publikun dhe zbatimit të ndryshimeve të reja ligjore, si dhe tematika të tjera që do të dalin gjatë vitit;
- Për garantimin e rregullit të sigurisë në Gjykatë është imediate instalimi i një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces , për identifikimin e sendeve të paligjshme.

- Për marrjen e masave organizative për alokim fondesh për investim për plotësimin e nevojave për rikonstrukcion të dhomës të serverit.

Sa më sipër është i domosdoshme krijimi i ambienteve të reja të gjykatës, një ambient shtesë me qera ose në planine afatgjatë një godine e re për institucionin, gjë e cila do të plotësonte pjesën më të madhe të objektivave afatshkurtra dhe afatmesme të institucionit.

Në përfundim, duke përfituar nga rasti, shprehim falënderime për të gjithë gjyqtarët, sekretarinë gjyqësore, si dhe të gjithë stafin e gjykatës, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur përmbylljen e një viti të ngarkuar dhe të vështirë për shkak të problemeve të shkaktuar nga procesi i vettingut, numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve, ambienteve të kufizuara të punës dhe numrit të pamjaftueshëm të ndihmësve ligjorë.

KËSHILLI I GJYKATËS